

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0051-A0001***Paditësi/Ankuesi***S Sh M**, fshati K, Lipjan**Kundër:***E paditura***N.SH. “Mbushtorja e Pijeve Coca Cola”** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0339, të datës 11 janar 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Ndryshohet ex officio Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0339, i datës 11 janar 2022.
3. Vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 i datës 18 dhjetor 2013.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 20 janar 2014, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 të datës 18 dhjetor 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 10,325.00 euro, për një periudhë të paspecifikuar kohore, ishte refuzuar si e pavlefshme. Kjo për faktin se pasi që AL kishte vërejtur informata dhe dëshmi të pamjaftueshme, me 11 tetor 2013 kishte dërguar një letër parashtruesit nga i cili kërkonte justifikim për parashtrimin me vonesë të kërkesës dhe informata/dëshmi plotësuese si periudhën e kërkuar dhe dokumentacion tjetër relevant. Pasi që kërkesa e AL nuk kishte arritur tek parashtruesi, njoftimi ishte publikuar në gazetata shqip “T” dhe “E e R” dhe gazetata serbe “D” dhe “V” me 14 nëntor 2013, duke qartësuar se parashtruesi është dashur të paraqitet tek zyra rajonale e AKP-së në Prishtinë dhe ka shtuar një paralajmërim se mosparaqitja e tij do të konsiderohet komunikim me të gjitha efektet respektive ligjore.

Në ankesën e paditësit theksohet se pretendimet e AKP-së janë të pasakta, të pavërteta dhe të paqëndrueshme. Kërkesën e datës 11 tetor 2013 parashtruesi i ankesës e kishte pranuar me datë 17 tetor 2013 në mënyrë postare nga posta e Lipjanit. Në afatin e paraparë ishte përgjigjur AKP-së për parashtrimin kinse me vonesë të kërkesës për paga të papaguara dhe atë me datë 29 tetor 2013. Andaj, në bazë të këtyre kërkon nga gjykata që të pranohet ankesa si e bazuar, çështja të kthehet në rishqyrtim të serishëm apo gjykata të vendos vet në mënyrë meritore duke pranuar si të bazuar kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 10,325.00 euro. Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 të datës 18 dhjetor 2013, formularin e kërkesës për likuidim, autorizimin për përfaqësim, një Aktgjykim P.nr.341/94 të datës 20 shkurt 1996 dhe kopjen e librezës së punës së paditësit.

Me datë 22 shkurt 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se pala kundërshtare i përmbahet qëndrimit se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore. Parashtruesi nuk kishte paraqitur asnjë argument juridik duke mos respektuar kështu nenet 70.2 dhe 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 të cilët urdhërojnë parashtruesit e ankesave kundër vendimeve të AL-së që të përfshijnë argumentet juridike në ankesat e tyre. Gjykata nuk mund të zëvendësoj palët në procedurë duke ofruar

argumente juridike në vendin e tyre. Sa i përket meritave të vendimit, pala kundërshtare ri konfirmon se vendimi është i bazuar në ligj dhe prova. Gjithashtu, e njëjta konsideron se të gjitha publikimet që janë të detyrueshme sipas ligjit janë kryer në kohë, prandaj parashtruesi kishte ose duhej të kishte dijeni lidhur me afatin e parashtrimit të kërkesës. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin PRN007-0002 të datës 11 tetor 2013 dhe një kërkesë për emërimin e përbërjes së Autoritetit të Likuidimit të datës 12 dhjetor 2012.

Me datë 15 korrik 2021, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e gjykatës të datës 1 korrik 2021, në të cilën kishte theksuar se ekziston rreziku që të humben faktet relevante të këtij kontesti duke pasur parasysh se ish sekretari i ndërmarrjes dhe deri tani avokati i tij I D, tani i ndjerë, pasi ka kohë që ka vdekur, ka në arhivën e tij gjithë dokumentacionin plotësues për secilin punëtor. Andaj, i njëjti gjithçka që kishte për momentin në dispozicion ishte vendimi mbi pushimin vjetor të datës 21 tetor 1998. Andaj kërkon që kërkesa e tij të merret seriozisht dhe të has në mirëkuptim duke rezultuar me efikasitet dhe gatishmëri që drejtësia mbi të gjitha të zotëroj dhe të zbatohet në afat sa më të shkurtër.

Me datë 10 gusht 2021, e paditura kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit në të cilën i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën e tij duke i konsideruar si të pabazuar dhe propozon që si të tilla duhet të refuzohen si të pabazuara.

Paditësi kishte bashkëngjitur disa prova në këtë lëndë dhe atë: ankesën e paraqitur pranë DHPGJS-së me datë 20 janar 2014, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 të datës 18 dhjetor 2013 dhe një parashtrësë e paditësit e datës 29 tetor 2013.

Me datë 11 janar 2022, në seancën dëgjimore të mbajtur në Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me lëndën C-IV-14-0339, paditësi deklaroi se fillimisht e kishte angazhuar avokatin në lidhje me realizimin e së drejtës së tij në procedurë të likuidimit. Dokumentacioni që i njëjti e ka pasur, e kishte avokati i cili tani është i ndjerë dhe kërkesën e tij e kishte bazuar në një Aktgjykim të Gjykatës Komunale në Lipjan dhe atë C.nr.4341/94. Ndërsa, e paditura kishte deklaruar se sa i përket vendimit të AL-së, i njëjti është konform ligjit sepse paditësi ka parashtruar kërkesën e tij pas afatit që ka qenë deri me datë 5 shkurt 2006,

ndërsa paditësi kërkesën e kishte parashtruar me 8 mars 2006 dhe AL i kishte marrë të gjitha veprimet e kërkuara. Gjithashtu paditësi nuk është përgjigjur as në shkresën që AKP i kishte dërguar të njëjtit, andaj AL kishte nxjerrë vendim me të cilin e kishte refuzuar kërkesën e tij. Paditësi si provë kishte dorëzuar formularin e kërkesës kreditore të datës 6 mars 2006, autorizimin për angazhim të avokatit të datës 2 mars 2006, aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale ën Lipjan C.nr.4341/94 si dhe librezën e punës, ndërsa e paditura kishte paraqitur kërkesën për paditësin të datës 11 mars 2013.

Me datë 11 janar 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0339 kishte shfuqizuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit, ndërkohë kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar pjesërisht në pretendimin e tij në lidhje me çështjen e komunikimit të AKP-së me paditësin për të arsyetuar shkakun e vonesës së kërkesës kreditore dhe të publikimit të kërkesës së Autoritetit të Likuidimit në gazetatat “T” dhe “E e R”. Gjykata vlerëson se AL nuk e ka kryer komunikimin në përputhje me dispozitat ligjore të LPK-së sepse AL nuk ka dorëzuar asnjë provë të vlefshme se ka tentuar që paditësit t’ia dorëzoi parashtrësën/kërkesën e AL-së në adresën e paditësit në fshatin K, Komuna e Lipjanit. Gjykata thekson se paditësi në formular të kërkesës qartë ka shënuar adresën e tij dhe numrin e telefonit fiks. AL në rastin konkret publikimin në gazeta të kërkesës e ka bërë ka shterur të gjitha mjetet për dorëzimin e rregull të kërkesës dhe pa u dorëzuar në rregull kërkesa si dhe pa u vërtetuar saktë se paditësi a e ka ndërruar adresën e tij, sikundër që në shkresa të lëndës paditësi kishte angazhuar avokatin I D i cili tani është i ndjerë dhe kërkesën na fjalë është dashur t’ia dorëzoj edhe avokatit. Pasi që t’i kishte shterë të gjitha këto mundësi ligjore të komunikimit me paditësin, është dashur që kërkesën ta publikoi në gazetë. Andaj për shkak të këtyre shkeljeve procedurale të komunikimit të AL me paditësin-parashtruesin e kërkesës vlerësoi se vendimi i AL-së nuk është i ligjshëm me rastin e zbatimit të dispozitës së nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe për këtë arsye ai është shfuqizuar. Sa i përket kërkesës së paditësit, gjykata arsyeton se paditësi përveç dëshmisë për pushimin vjetor për vitin 1998 nuk ka dorëzuar ndonjë provë se në cilën datë është kthyer në vendin e punës, përveç që është deklaruar se është kthyer në punë te i padituri nuk ka dorëzuar ndonjë provë se i është drejtuar të paditurës me ndonjë kërkesë për pagimin e pagave të pretenduara të cilat nuk i janë paguar. Gjykata vlerëson se edhe nëse paditësi nuk i ka kërkuar pagat te e paditura ai nuk ka dorëzuar asnjë provë që provon lartësinë e pagës mujore

gjatë periudhës që ka qenë i larguar nga puna dhe në bazë të kësaj page mujore të vërtetohet pretendimin e tij në shumën e kërkuar. Në rastin konkret, pavarësisht se paditësit me Aktgjykim të formës së prerë i është krijuar baza juridike për të kërkuar pagat e pretenduara, paditësi nuk e kishte provuar me asnjë provë se e paditura me rastin e kthimit në punë nuk ja ka paguar pagat dhe se për shkak të kësaj e paditura i ka borxh paditësit dhe nuk e provoi shumën e pretenduar.

Me datë 2 shkurt 2022, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-0339 të datës 11 janar 2022, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit gjyqësor, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ta anuloj Aktgjykimin e ankimuar sa i përket pikës II dhe III, ndërsa lëndën ta kthej përsëri në procedurë të rigjyimit në shkallë të parë apo të vendos në mënyrë meritore duke pranuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit e duke obliguar të paditurës t'i kompensoj paditësit pagat e papaguara nga marrëdhënia e punës për periudhën nga 11 prill 1994 deri më 27 janar 1997, gjithsej 33 muaj, në shumën e përgjithshme prej 10,325.00 euro duke u bazuar në Aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës komunale në Lipjan, C.nr.341/94 të datës 20 shkurt 1996, që ka hyrë në fuqi nga data 19 qershor 1996. Në ankesë theksohet se paditësi specifikisht kishte kërkuar pagat e papaguara nga data 11 prill 1994 kur edhe është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme e të dhunshme sipas vendimit të menaxhmentit të dhunshëm të vendosura nga ish regjimi diskriminues i Serbisë në Kosovë. Andaj, paditësi me bazë të plotë ligjore bazuar në Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.341/94 të datës 22 shkurt 1996, i cili kishte hyrë në fuqi me 19 qershor 1996, fakt ky që e ka pranuar edhe gjykata me aktgjykimin e ankimuar, ka kërkuar vetëm pagat e papaguara për periudhën sa ka qenë i suspenduar dhunshëm. Paditësi thekson se pas rikthimit në punë me datë 27 janar 1997, disa herë kishte kërkuar nga menaxhmenti i dhunshëm i ndërmarrjes pagat e papaguara por një gjë e tillë është refuzuar kategorikisht nga të njëjtit, me kërcënim për largim të serishëm nga puna. Paditësi nuk ka pasur mundësi të parashtrij propozim për ekzekutimin e Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të ngjarjeve të luftës 1998/1999, fakt që do të duhej të merrej parasysh nga gjykata. Edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 11 janar 2022 e paditura nuk kishte ofruar asnjë dëshmi se a janë paguar pagat e kërkuara për periudhën e suspendimit, gjë që është obligim ligjor i të paditurës. Prandaj, paditësi në këtë rast konsideron se gjykata ka vendosur pa asnjë provë, vetëm me supozim, parashikim, hamendësi, se paditësi ka mundur të pranoj pagat e papaguara dhe tani për të dytën herë parashtron kërkesë të ngjashme. Andaj, duke u bazuar në

këto fakte e prova gjykata ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar i çështjes faktike dhe rrjedhimisht edhe i aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit gjyqësor nga ana e gjykatës.

Me datë 29 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën propozon që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së nuk është i drejtë në rezultat dhe në arsyetimin e tij dhe si i tillë i njëjti duhet të ndryshohet ex officio.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 10,325.00 euro për periudhë të pacaktuar ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit për arsye se i njëjti kishte konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk i ishte përgjigjur kërkesës së AL-së pasi që kërkesa nuk kishte arritur tek i njëjti dhe e njëjta më pas ishte publikuar në gazeta ditore, ku edhe pas kësaj parashtruesi nuk i ishte përgjigjur kërkesës.

Paditësi në ankesën e tij në shkallë të parë si prova kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 të datës 18 dhjetor 2013, formularin e kërkesës për likuidim, autorizimin për përfaqësim, një Aktgjykim P.nr.341/94 të datës 20 shkurt 1996 dhe kopjen e librezës së punës së paditësit.

Shkalla e parë e DHPGJS, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin kishte shfuqizuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit, ndërsa kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit si të pabazuar.

Kolegji i Apelit vëren se edhe pse shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vendosur që kërkesën e paditësit për kompensim të pagave të papaguara ta konsideroj të afatshme, përkundër faktit që e kishte paraqitur pas afatit, të njëjtën e kishte refuzuar si e pabazuar në mungesë të provave, konstatim ky me të cilin nuk pajtohet edhe Kolegji i Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi e kishte paraqitur kërkesën e tij para Autoritetit të Likuidimit me datë 8 mars 2006, që sipas vlerësimit të Autoritetit të Likuidimit është e paraqitur pas afatit për parashtrimin e kërkesave që ishte me 5 shkurt 2006.

Paditësi me rastin e paraqitjes së ankesës së tij nuk e kishte kontestuar faktin se kërkesën e kishte paraqitur pas afatit për parashtrimin e kërkesave.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se pasi që paditësi e kishte paraqitur kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit me vonesë, përkatësisht me datë 8 mars 2006, që është pas afatit për parashtrimin e kërkesave dhe atë me 5 shkurt 2006, e njëjta duhet të konsiderohet e pasafatshme, ashtu siç e kishte konsideruar edhe Autoriteti i Likuidimit.

Nga arsyet e cekura më lartë, aktgjykimi i ankimuar ndryshohet ex officio dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN007-0002 të datës 18 dhjetor 2013.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
